



Bashkia Tiranë

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve

Spektori i Zhvillimit dhe Kujdesit Psiko-Social

www.femijetetiranes.al



Programi i Edukimit në Çerdhe

Muaji Korrik

6 - 18 Muaj

Programi i Edukimit në Çerdhe, Muaji Korrik

Grupmosha: 6 - 18 muaj



Tiranë, 2022

Ky material, është vazhdimësi e materialeve, modeleve të përgatitura nga Sektori Psiko-Social, sipas muajve (tetor-korrik) në kuadër të hartimit dhe zbatimit të Programit të Edukimit në Çerdhet Publike, Bashkia Tiranë.

Ky material i shërben stafit edukator për përmirësimin e cilësisë së edukimit të fëmijëve në çerdhet publike të Bashkisë Tiranë, të grupmoshës 6 muajsh-3 vjeç, që frekuentojnë këto insitucione.

Programi përmban një larmi tematikash, aktiviteteve, lojërash sipas çdo jave duke i dhënë në këtë mënyrë hapësirën fëmijëve të gjejnë veten në të gjitha aktivitetet kreative brenda tij.

Programi është krijuar si model për të ndihmuar stafin edukator në kornizimin më mirë të rutinës në marrëdhënie me fëmijët.

Në zbatimin, realizimin e aktiviteteve, stafi edukator në marrëdhënie me fëmijët duhet të marrë në konsideratë kushtet atmosferike të muajit, temperaturat e larta, por dhe mungesat për shkak të pushimeve.

Stafi edukator të ndjehet i lirë të realizojë atë çfarë pëlqejnë fëmijët, duke u konsultuar me kolege dhe stafin mbështetës. Gjatë ditës mund të realizohen edhe aktivitete të tjera.

Punë të mbarë!

© Përmbajtja e këtij materiali mund të përdoret nga specialistë të tjerë të fushës, por jo për qëllime fitimi me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e DPÇK , Sektorit Psiko-Social si burim.



Programi i Edukimit në Çerdhe, Muaji Korrik

Karakteristikat e muajit.

Përshëndetje, të dashur fëmijë!

Përshëndetje edukatore!

Vera si të gjitha stinët e tjera ka tre muaj dhe Korriku është muaji i dytë i saj. Mendohet se Korriku është muaji më i nxehtë i vitit, për shkak të temperaturave të larta që e karakterizojnë.

Korriku është gjithashtu një muaj i begatë. Ai njihet si muaji i të korrave sepse piqen drithrat: gruri, misri, me të cilat bëhet mielli, buka, ëmbëlsirat, etj. Por në korrik, si në muajt e tjerë të verës ne shijojmë edhe plot fruta: pjeshka, kajsi, fiku, bostani etj.

Në korrik shumica e familjeve dhe fëmijëve ndjehen më të gëzuar, më të shpłodhur pasi për një pjesë puna lihet pak mënjane për të nisur pushimet verore pranë detit, liqenit, pishinave, malit, etj.

Muaji Korrik

Tema e Muajit: Pushimet Verore

Grupi: 6 - 18 muaj



Java I: Përgatitja për pushimet.




Java II: Lodrat, sendet, ngjyrat e pushimeve.



Java III: Ushqehemi shëndetshëm gjatë ditëve të nxehta të verës.

Java IV: Miqtë e vegjël të verës. Tingujt.

Tema mujore: Pushimet Verore		
Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Përgatitja për pushimet.	Vendet ku mund të kalojmë pushimet e verës.	Java I
Lodrat, sendet, ngjyrat e pushimeve.	Njohja dhe nxitja e fëmijëve për të emërtuar lodrat, sendet, ngjyrat e tyre që përdorin kur shkojnë me pushime.	Java II
Ushqehemi shëndetshëm gjatë verës.	Ushqimet e shëndetshme dhe lëngjet që të freskojnë në verë.	Java III
Miqtë e vegjël të verës. Tingujt.	Përforcimi i njohjes së ngjyrave, numrave, tingujve.	Java IV
Shënim: <ul style="list-style-type: none">* Edukatorët duhet ta realizojnë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim përvetësimin sa më të thjeshtë të njohurive nga fëmijët.* Stafit edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre. Diskutimi i tyre me fëmijët në shtëpi.		

Tema mujore: **Pushimet Verore**
Tema e javës: **Përgatitja për pushime**
6 - 18 Muaj




Java I - Ditët	Tema e ditës	Aktivitetet	Mjetet e punës
E Hënë	<p style="text-align: center;">Pushimet e mia</p> 	<p>Vjersha: “Deti”.</p> <p>Loja: “Me ujë”.</p> <p>Lodrat vendosen në një enë me ujë, futen-nxirren, ndihmohen fëmijët t’i prekin, numërimi 1, 2, 3, shkathtësojnë duart. Koncepti brenda-jashtë.</p> <p>Lojë me muzikë: Fëmijët kërcëjnë, argëtohen me muzikë.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Lodra të ndryshme, kovë, legen</p>
E Martë	<p style="text-align: center;">Deti, Lodrat</p> 	<p>Elementët e plazhit: kova, lopata, peshku etj. Demonstrimi i tyre(nëse ka në grup).</p> <p>Vjersha: “Deti”.</p> <p>Loja me ujë: Edukatorja ndihmon fëmijët të mbushin, zbrasin ujin në kovë, të hedhin lodrat, t’i prekin. Vijon koncepti brenda-jashtë.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Lodra plazhi, kovë, legen etj.</p>
E Mërkurë	<p style="text-align: center;">Liçeni, Rosat</p> 	<p>Kënga: “Rosat lahen në liçen”.</p> <p>Loja imituese: “Lëvizim krahët si rosat”.</p> <p>Edukatorja modelon fëmijët përmes lëvizjeve të saj.</p> <p>Këngë lëvizore.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>



<p>E Enjte</p>	<p>Fshati, Patat</p> 	<p>Vjersha: “Pata qafëgjata”.</p> <p>Loja: “Imitimi i patateve”. Demonstrimi i tyre.</p> <p>Loja: “Me kuba”.</p> <p>Vendosja një mbi një. Numërimi 1, 2, 3.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Kuba</p>
<p>E Premte</p>	<p>Shtëpia e gjyshes.</p> 	<p>Vjersha: ”Gjyshja ime”.</p> <p>Lojë: Loja e telefonit –”Alo nëna... ”,- Improvizimi.</p> <p>Lojra me muzikë: Me lëvizje të orientuara nga edukatorët.</p> <p>Aktivitet: Me ndihmën e edukatoreve fëmijët formojnë me kuba “shtëpinë e gjyshes”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Kuti shkrepe, spango, lodra telefon.</p>

Tema mujore: **Pushimet Verore**

Tema e javës: **Lodrat dhe sendet e pushimeve.**




6 - 18 Muaj




Java II - Ditët	Tema e ditës	Aktivitetet	Mjetet e punës
E Hënë	<p>Kapelja ime</p> 	<p>Loja: “Me kapele”.</p> <p>Edukatorja ndihmon fëmijët të vendosin kapelet në kokë, ti rrotullojnë dhe ti heqin ato (bashkëpunimi me prindërit për t’i sjellë).</p> <p>Lojë energjike: “Kapim mollën.”</p> <p>Lojra me muzikë: Me lëvizje të orientuara nga edukatoret.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Manuali i Lojrave</p> <p>Kapele të ndryshme</p>
E Martë	<p>Lodrat e plazhit</p> 	<p>Aktivitet: “Një ditë në breg”.</p> <p>Edukatoret së bashku me fëmijët numërojnë- “1, 2, 3“, dhe emërtojnë lodrat e plazhit.</p> <p>Vjersha: “Deti”.</p> <p>Loja: “Pasimi i topit” (për moshën mbi 15 muajsh). Fëmijët pasojnë topin tek njëri-tjetri.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Lodra plazhi</p>
E Mërkurë	<p>Topi im</p> 	<p>Vjersha: “Topi im”.</p> <p>Loja: “Gjejmë topin e fshehur”.</p> <p>Edukatorja mund ta fshehë topin në çarçaf. Ajo ju kërkon fëmijëve ta gjejnë, hedhin dhe rrokullisin atë (6-18 muajsh).</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Manuali i Lojrave</p> <p>Topa me ngjyra</p>

<p>E Enjte</p>	<p>Libri, miku im</p> 	<p>Lojë: “Libri”.</p> <p>Edukatorët tregojnë fëmijëve libra ose revista me figura. Fëmijët ndihmohen nga edukatorja për të treguar me gisht figurat.</p> <p>Loja: “Loja e përkimit të ngjyrave”(ngjyrat bazë). Vendosja e tre koshave me ngjyra të kuqe, blu, i verdhë. Hedhja e lodrave sipas ngjyrave në koshat përkatës.</p> <p>Lojë energjike: Me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja.</p> <p>Përralla: “Pinoku”.</p>	<p>Manuali i Lojrave Libra, revista, top, kosha Libri “365 rrëfenja para gjumit” (f.99).</p>
<p>E Premte</p>	<p>Me tren për pushime</p> 	<p>Loja: “Treni”- imitimi...çaf-çuf..</p> <p>Aktivitet: Improvizimi duke u kapur pas njëri-tjetrit(mbi 15 muajsh). Fëmijët ndihmohen nga edukatorja. Numërojmë vagonat 1, 2, 3.</p> <p>Këngë lëvizore.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>

Tema mujore: **Pushimet Verore**

Tema e javës: **Ushqehemi shëndetshëm gjatë ditëve të nxehta të verës.**
6 - 18 Muaj




Java III - Ditët	Tema e ditës	Aktivitetet	Mjetet e punës
E Hënë	Uji dhe lëngjet e freskëta 	Aktivitet: “Përgatitja e lëngut ose kos me fruta”- të përdoren frutat në menunë ditore të çerdhes. Lojë: “Me ujë ose rërë”. Edukatorët së bashku me fëmijët presin kuti ose shishe në mes. Gjysma e sipërme e kutive/ shisheve mbushet me ujë, rërë dhe lihet fëmija të shohë si bie uji/rëra (shiko modelin).	Manuali i Lojrave Fruta të ndryshme, kuti, shishe, ujë, rërë
E Martë	Frutat e freskëta 	Loja: “Treni”. Recitohet duke bërë zëvendësimin e frutave. Aktivitet: Përmes formave, fotove, lodrave edukatorja u tregon fëmijëve frutat (6-12 muajsh). Lejojini fëmijët ti mbajnë në duar dhe ti prekin ato. Muzikë dhe këngë: Argëtimi i fëmijëve.	Manuali i Lojrave Foto, libra, revista, lodra etj.
E Mërkurë	Qershia 	Vjersha: “Qershia”. Loja: “Frutat në vendin e duhur”.(12-18 muajsh) Fëmijët me ndihmën e edukatoreve gjejnë format e frutave përmes lodrave prej druri dhe pazëll. Lojë energjike: Me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja.	Manuali i Vjershave Lodra druri, pazëll.



<p>E Enjte</p>	<p style="text-align: center;">Karrota Aeroplani prej karrote</p> 	<p>Vjersha: “Karrota”. Aktivitet: “Aeroplani me karrotë”. Eduktorja pastron një karrotë duke shpjeguar dhe vetitë e saj. Së bashku me fëmijët vendos krahët, bishtin e aeroplanit duke prerë një karton ose kanaçe (shiko modelin). Loja: “Kërcimi në vend”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Karrotë, karton, kanaçe etj.</p>
<p>E Premte</p>	<p style="text-align: center;">Luledielli</p> 	<p>Aktivitet: “Luledielli”. Eduktorja së bashku me fëmijët krijojnë lulediellin duke përdorur plastelinë, brumë, shkopa ose pipëza me ngjyrë të verdhë (shiko modelin). Nëse krijohet si “Maskë” shihet dhe shfaqet fytyra e fëmijës. Preken sytë, hunda me gisht(6-12 muajsh). Loja: “Me kuba”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Plastelinë, pipa, karton, lapsa, pipa etj.</p> 

Tema mujore: **Pushimet Verore**

Tema e javës: **Miqhtë e argëtimit në verë.**

6 - 18 Muaj

Java IV - Ditët	Tema e ditës	Aktivitetet	Mjetet e punës
<p>E Hënë</p>	<p>Pipëzat</p> 	<p>Loja: “Pipëzat”. Edukatorja përmes pipëzave mund të fryjë në ajër,(6-12muajsh). Fëmijët mund të fryjnë fluskat, mund t’i kapin (12-18 muajsh). Loja energjike: “Roza-rozina” (mbi 15 muajsh). Vjersha: “Rosat lahen në liqen.”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Gotë, ujë, pipa</p>
<p>E Martë</p>	<p>Tullumbacja</p> 	<p>Vjersha: “ Tullumbace të kam xhan”. Loja: “Prekim - hedhim tullumbacen” Tullumbacja mund të mbushet me oriz, fasule, kopsa të vogla, fëmijët dëgjojnë tingullin që krijohet (shiko modelin). Lojë energjike: ”Kërcimi në vend”.</p>	<p>Tollumace, oriz, fasule, sende te vogla</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Tingujt përmes pjatave</p> 	<p>Loja: “Pjatat”. Tek dy kapakë tenxheresh, edukatorja lidh një kordele (shiko modelin). Fëmijët përplasnin kapakët për të dëgjuar zhurmat dhe tingujt që krijohen. Kërcejmë sipas ritmit të goditjeve. Koncepti i zhurmave të ulëta-të larta, koordinimi i lëvizjeve të duarve me shikimin. Kënga: “A Ram Sam Sam.”</p>	<p>Kapakë, fjongo Magnetofon</p>

<p>E Enjte</p>	<p>Buzëqeshja, Emoji</p> 	<p>Loja: “Buzëqeshja ime”.</p> <p>Edukatorët krijojnë tre emocione me emoji: i qeshur, i mërzhitur, i zemëruar (shiko modelin). Edukatorja ndihmon fëmijët të gjejnë fytyrën e qeshur.</p> <p>Edukatorja i tregon fëmijëve fytyrën e qeshur dhe i kërkon ta imitojnë atë.</p> <p>Këngë lëvizore: “Kur jam i gëzuar përplas duart”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Letra me ngjyra, ngjitës, shkopa, pipa etj.</p>
<p>E Premte</p>	<p>Krimbi i vogël</p> 	<p>Punë dore: “Krimbi ”.</p> <p>Edukatorët së bashku me fëmijët krijojnë krimbin me letra/plastelinë dhe ngjisin numrat sipas renditjes 1, 2, 3. (shiko modelin)</p> <p>Vjersha: 1, 2, 3</p> <p>Përrallë; “Kërcimi i kërmillit.”</p> <p>Lojë: “Ecja drejt”.</p>	<p>Letra me ngjyra, plastelinë, lapsa, ngjitës etj.</p> <p>Libri:“365 rrëfenja para gjumit(f.99).</p> 